



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br \_\_\_\_\_ 218/24  
Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_ - 1 -  
Data: / Datum \_\_\_\_\_ 02.12.2024  
VUSHTRRI - VUÇITRAN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (KKV) Nr. 03/2023 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridike, OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **2 dhjetor 2024** merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR Z. SABRI FEJZULLAHU**

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej tri mijë euro (3,000.00 €), për z. Sabri Fejzullahu, për ndërtimin e pllakës përkujtimore dhe parkun përreth, për familjarin e tyre z. Milaim Fejzullahu, ish-Komandant në Policinë e Kosovës.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit (180) i Drejtorisë për Shërbime Publike, kodi i nën-programit (18184) infrastrukturë publike. Në mungesë të mjeteve në këtë drejtori, do të sigurohen nga njësitë e tjera buxhetore, ku ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, i njëjti do të zbatohet në vitin 2025.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesnese e Kuvendit**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRIN

Of Nr. / Br 219/24

Nr. i fq. / Br. sf - 1 -

Data: / Datum 02.12.2024

VUSHTRRI - VUÇITRIN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (KKV) Nr. 03/2023 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë, OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **2 dhjetor 2024** merr këtë:

### V E N D I M

#### PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR ZNJ.BELINDA MEHANA

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej tre mijë euro (3,000.00 €), për znj. Belinda Mehana, për realizimin e koncertit solistik të diplomës.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit (920) i Drejtorisë për Arsim, kodi i nën-programit (92120)-administrata. Në mungesë të mjeteve në këtë drejtori, do të sigurohen nga njësitë e tjera buxhetore, ku ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja e Arsimit, Drejtorja për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, i njëjti do të zbatohet në vitin 2025.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	220/24
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	02.12.2024
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 datë 04 qershor 2008), si dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datën **2 dhjetor 2024** merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR SHFUQIZIM TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 178/16 datë 29.09.2016 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së Komunës së Vushtrrisë.
2. Qëllimi i shfuqizimit të vendimit të cekur në pikën paraprake është krijimi i mundësisë për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Shërbime Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**